



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

GJAKOVA



**Zyra e Prokurimit**  
**Dt. 08.08.2025**

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 37, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi : 632-23-7179-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-104-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-17517, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, me dt.08.08.2025, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

**VENDIM**

**Për ndërprerjen të Kontratës**

1. Për shkak të dështimit për të përmbushur obligimet kontraktuale, që parqet element thelbësorë të kontratës, kontrata me numër të prokurimit : 632-23-7179-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-104-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-17517, e nënshkruar me datën 01.09.2023 me titull “ Rivitalizimi i Eshtnores-faza II, në mes të Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit N.T.Sh. “ Marash – Shped” ; SH.P.K COMPANY “ BEJTA COMERCE” SH.A rr. Sadik Stavileci K. Gjakovë,, NDËRPRITET.
2. Për shkak se kryesi i punëve N.T.Sh. “ Marash – Shped” ; SH.P.K COMPANY “ BEJTA COMERCE” SH.A rr. Sadik Stavileci K. Gjakov, është përgjegjës për mos përmbushje të obligimeve që dalin nga kontrata edhe pse është informuar disa here radhazi për vazhdimin e punimeve përmes e-maileve, të datave: 29.03.2024, 27.05.2024, 14.03.2025 dhe 21.03.2025, obligime këto që janë kusht esenciale dhe themelor i kontratës, NDËRPRITEN së vepruari të gjitha raportet dhe marrëdhëniet Autoritet Kontraktues – Kryes i punëve , të rregulluara me Kontratën me numër të prokurimit: : 632-23-7179-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-104-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-17517, e nënshkruar me datën 01.09.2023, për çka Autoriteti Kontraktues, do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
3. Me qëllim të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga veprimet e pajustificuara të Furnizuesit, Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

## A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin e prokurimit për "Rivitalizimi i Eshtnores-faza II, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit N.T.Sh. "Marash – Shped"; SH.P.K COMPANY "BEJTA COMERCE" SH.A rr. Sadik Stavileci K. Gjakovë, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës së dërguar në Zyrën e Prokurimit me date 04.08.2025, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen e Kontratës.

Me date 07.08.2025, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar "Njoftimin për ndërprerje të kontratës" te kryesi i punëve N.T.Sh. "Marash – Shped"; SH.P.K COMPANY "BEJTA COMERCE" SH.A rr. Sadik Stavileci K. Gjakovë.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

### UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini



Kryetari i Komunës



Faton Gutaj



Zyrtar përgjegjës i prokurimit

### Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport  
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;  
Menaxherit të kontratës;  
Organit Mbikëqyrës;  
Arkivës së Komunës.